



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA TROPOJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

B.Curri, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2018

### Rregullore e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike

#### Bashkia Tropoje

Mbështetur në nenin 29 dhe 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore, neni 11/3, paragrafi d dhe neni 78/2 i ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Dhunës në Familje" dhe "Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" duhet të krijohen në nivel bashkie "Këshilli Vendor për Sigurinë Publike".

#### Neni 1

##### Përkufizim

**Këshilli Vendor për Siguri Publike (KVSP)** është një forum i përberë nga të gjithë aktorët vendorë, institucionet publike, OJF-të, grupet vendore të interesit dhe qytetarët, i krijuar për të diskutuar për sigurinë publike në vend si dhe për të rritur bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet aktorëve dhe partnerëve të ndryshëm vendor për të zgjidhur çështjet e sigurisë vendore.

Fushëveprimi i punës së KVSP është i kufizuar vetëm brenda kufijve të Bashkisë.

#### Neni 2

##### Qëllimi i punës së KVSP-ve

KVSP-të nuk ushtrojnë ndonjë interes ekonomik.

Qëllimi i KVSP-së, është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në Bashki nëpërmjet:

- a) identifikimit të problemeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik
- b) identifikimit të pikave të nxehta përsa i përket situatës kriminale, aksidenteve në qarkullimin rrugor, sjelljeve anti-shoqërore dhe kundërvajtjeve dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve
- c) rritjes së ndjenjës së sigurisë publike
- d) nxitjes së angazhimit vullnetar në partneritetet publike
- e) krijimit të besimit ndërmjet administratave publike përgjegjëse për sigurinë publike dhe grupeve të komunitetit dhe qytetarëve
- f) hartimit të rekomandimeve dhe aktiviteteve për rritjen e sigurisë dhe rendit publik drejtuar autoriteteve përgjegjëse për:
  - a) identifikimin e çështjeve që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik
  - b) diskutimin e raporteve dhe të dhënave lidhur me sigurinë në Bashki dhe identifikimin e masave për adresimin e problemeve
- g) mbështetjes së policisë vendore në zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Vendore për Siguri në Komunitet.
- h) diskutimit dhe këshillimit për caktimin e buxhetit dhe projekteve që lidhen me rritjen e sigurisë në komunitet.

### **Neni 3 Anëtarët**

Anëtarët e KVSP-së janë

- Kryetari i Bashkisë
- Shefi i *komisariatit Policise Tropoje*
- Shefi i policisë Bashkiake

një përfaqësues nga

- Administrata e Shërbimeve Sociale
- Administrata e Shërbimit Shëndetësor
- Administrata e Inspektoriatit të Mjedisit
- N/Prefekti
- Këshillat e prindërve në territorin e bashkisë
- Secili komunitet fetar
- Grupet vullnetare të krijuar për të rritur parametrat e sigurisë publike në Bashki
- Pakicat kombëtare
- OJF-të

- Komuniteti i biznesit

Të tjerë pjesëmarrës mund të ftohen në mbledhjet e KVSP në varësi të temave të rendit të ditës.

Identifikimi i anëtarëve ose i të ftuarve bëhet nga Kryetari dhe / ose anëtarët e tjerë të KVSP-së.

#### **Neni 4 Struktura**

Këshilli Vendor për Siguri Publike përbehet nga struktura e mëposhtëm:

- Kryesuesi
- Zëvendës Kryesuesi
- Sekretari
- Grupet e Punës
- Plenumi

#### **Neni 5 Kryesuesi i Mbledhjes**

Kryetari i Bashkisë është kryesuesi i KVSP-së. Ai kryeson mbledhjen e KVSP-së, përgatit agjendën në konsultim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin dhe thërret mbledhjen. Kryesuesi emëron sekretarin e KVSP-së, i cili është punonjës i stafit të Bashkisë. Ai nënshkruan në emër të KVSP-së, dokumentet zyrtare (rezolutat, ftesat, deklaratat për shtyp dhe media, etj.). Në bashkëpunim me nënkryetarin, kryesuesi informon publikun për aktivitetet e KVSP-së.

#### **Neni 6**

##### **Zv. Kryesuesi i Mbledhjes**

Shefi i Komisarariatit Policise është zëvendës kryesuesi i KVSP-së. Ai / Ajo e mbështet kryetarin në funksionin e tij dhe e zëvendëson atë kur ai/ajo mungon. Në këtë rast ai / ajo ka të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si kryesuesi.

#### **Neni 7**

## **Sekretari**

Sekretari i KVSP-së, mbështet kryetarin sipas udhëzimeve të tij / saj. Ai / ajo është përgjegjës për dokumentet që kanë të bëjnë me KVSP-në. Ai/ajo duhet të dërgoje ftesat, të hartojë dokumentet dhe të përgatisë materialet e nevojshme për mbledhjet. Sekretari konsultohet me të gjithë anëtarët para mbledhjes dhe finalizimit të axhendës. Çdo anëtar ka të drejtë të përfshijë një temë në rendin e ditës. Rendi i ditës dhe dokumentet u shpërndahen të gjithë anëtarëve të paktën një javë para mbledhjes. Përveç kësaj, sekretari ka për detyrë të protokollojë dhe të mbajë proces verbalin e mbledhjes. Procesverbalet e mbledhjeve dhe lista e vendimeve u shpërndahen të gjithë anëtarëve dhe bëhen publike në faqet e internetit të Bashkisë dhe institucioneve të tjera.

## **Neni 8**

### **Grupet e Punës**

Për çështje të veçanta, krijohen grupe pune të posaçme (*ad hoc*), të përbëra nga përfaqësuesit e institucioneve në KVSP. Grupi i punës do të hartojë dhe formulojë në mënyrë të detajuar raporte, rekomandime, pyetje etj. në bazë të vendimit të plenumit, si dhe do të ndjekë zbatimin e rezolutave, propozimeve etj. nga autoritetet/ institucionet përgjegjëse. Grupi i punës mbështet sekretarin në detyrimet e tij/të saj.

## **Neni 9**

### **Plenumi**

Plenumi është organi vendimmarrës i KVSP-së, dhe përbëhet nga anëtarët e tij (neni 3). Plenumi do të mblidhet rregullisht çdo tre muaj. Për raste specifike, organizohet mbledhje me kërkesë të kryetarit ose të shumicës së anëtarëve të KVSP-së.

KVSP mund të mbajë mbledhje nëse në të merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryesuesit është vendimtare.

## **Neni 10**

### **Bashkëpunimi**

KVSP informon menjëherë autoritetet / institucionet përgjegjëse (Policinë, Këshillin Bashkiak, Gjykatën, Prokurorinë e Rrethit, Koordinatorin për Çështjet e Dhunës në Familje etj.) mbi gjetjet dhe rezultatet e arritura në lidhje me sigurinë dhe rendin publik.

Përveç kësaj, KVSP dërgon rekomandimet për masat që do të merren tek institucionet e përmendura më sipër. Më pas do t'u kërkohej institucioneve që të raportojnë mbi aktivitetet që do të kryhen për të zgjidhur problemet e sigurisë publike të diskutuara në KVSP.

KVSP, bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet e lartpërmendura për të arritur rezultate të prekshme për parandalimin e krimeve, sjelljeve anti-shoqërore dhe aksidenteve në qarkullimin rrugor. Nëse është e nevojshme, KVSP fton në mbledhje përfaqësuesit e institucioneve përkatëse për diskutuar çështjet.

Fryma që përshkon e organizimin e mbledhjeve dhe komunikimin në mbledhjet e mbajtura nga KVSP është fryma e bashkëpunimit dhe gjithëpërfshirjes. Vendimet kanë natyrë këshillimore për institucionet. Megjithatë, të gjithë anëtarët ftohen të marrin në konsideratë këto vendime në planifikimet dhe punën e tyre të përditshme.

## **Neni 11**

### **Raportimi**

Në fund të vitit, KVSP informon Këshillin Bashkiak për aktivitetet.

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 28.06.2018